

REZULTATET DHE RENDITJA E LIGËS SË PARË F DHE M

Sot, në Palestrën Astrit Bytyçi, në Ferizaj janë luajtur ndeshjet e javës së parafundit të sezonit vjeshtor për Ligën e Parë F&M.

LIGA E PARË F — SEZONI 2026

Te Liga e femrave, me vetëm një xhiro të mbetur, gara për vendin e parë është tepër e ngushtë: Kpp Gani Maloku dhe Kpp Shkolla Ahmet Hoxha F kanë saktësisht të njëjtin bilanc (10 fitore, 1 humbje) dhe të njëjtat 21 pikë. Gani Maloku kryeson në saje të bilancit më të mire në ndeshjet direkte: (në xhiron 6 fitoi Kpp Gani Maloku 3–1, ndërsa në xhiron 13, fitoi Kpp Shkolla Ahmet Hoxha F 3–2).

Vendi i parë teorikisht mbetet ende i hapur para xhiros së fundit por me pak gjasa që dy kryesuesit të pësojnë në javën e fundit.

Kpp Shpresa (18 pikë dhe Kpp Juniku (17 pikë) e kanë siguruar praktikisht vendin e tretë dhe të katërt, larg garës për titull por edhe larg zonës së poshtme të tabelës.

Në fund të tabelës, Kpp Istogu (14 pikë), Kpp Artana (12 pikë) dhe KVPP Prizreni (8 pikë, ende pa asnjë fitore) mbyllin renditjen.

Tabela e Renditjes

Nr.	Ekipi	Nd	F	H	PF	PH	+/-	Pikë	RZ
1	Kpp Gani Maloku	11	10	1	32	10	+22	21	—
2	Kpp Shkolla Ahmet Hoxha F	11	10	1	31	10	+21	21	—
3	Kpp Shpresa	11	7	4	25	14	+11	18	—
4	Kpp Juniku	11	6	5	24	17	+7	17	—
5	Kpp Istogu	12	3	9	12	30	-18	14	-1
6	Kpp Artana	11	3	8	11	25	-14	12	-2
7	KVPP Prizreni	11	0	11	4	33	-29	8	-3

Rezultatet e xhirove 12 dhe 13

Java	Ekipi Vendas	Rezultati	Ekipi Mysafir
12	Kpp Juniku	1 – 3	Kpp Gani Maloku
12	Kpp Shpresa	3 – 0	Kpp Istogu
12	KVPP Prizreni	0 – 3 rez. Zyrt.	Kpp Shkolla Ahmet Hoxha F
13	Kpp Juniku	3 – 0	Kpp Istogu
13	Kpp Shkolla Ahmet Hoxha F	3 – 2	Kpp Gani Maloku
13	KVPP Prizreni	0 – 3 rez. Zyrt.	Kpp Artana

LIGA E PARË M

Kpp Ponte Prizreni kryeson me bilanc perfekt — 13 fitore nga 13 ndeshje. Me 26 pikë dhe vetëm një xhiro të mbetur, titulli i sezonit të rregullt të Ligës së Parë M është praktikisht i siguruar. Kpp Gani Maloku mbetet e dyta me 24 pikë (11 fitore, 2 humbje) — 2 pikë prapa kreut, por tashmë pa asnjë mundësi matematikore ta kapërcejë Kpp Ponte Prizrenin edhe në rast fitoreje në xhiron e fundit.

Në vendin e tretë renditet Vushtrria me 20 pikë, para treshes Kpp TTC Ferizaj, Kpp Bifurkacioni dhe Kpp KVPP Prizreni që ndajnë vendet 4-6 me nga 19 pikë, secila. Renditja aktuale e këtyre tri ekipeve pasqyron raportin e ndeshjeve direkte ndërmjet tyre.

Në pjesën e poshtme, Kpp Ahmet Hoxha (15 pikë) dhe Kpp Hasan Prishtina (14 pikë) e kanë pothuajse të vulosur fundin e tabelës, pas një sezoni me shumë humbje për të dyja ekipet.

Xhiron e 14-të e fundit nuk do të ketë ndonjë impakt të rëndësishëm, pasi dy vendet e para që çojnë në Superligë dhe dy të fundit në Ligën e Dytë janë vendosur tanimë.

Tabela e Renditjes

Nr.	Ekipi	Nd	F	H	PF	PH	+/-	Pikë
1	Kpp Ponte Prizreni	13	13	0	39	6	+33	26
2	Kpp Gani Maloku	13	11	2	35	13	+22	24

Nr.	Ekipi	Nd	F	H	PF	PH	+/-	Pikë
3	Kpp Vushtrria	13	7	6	28	22	+6	20
4	Kpp TTC Ferizaj	13	6	7	28	24	+4	19
5	Kpp Bifurkacioni	13	6	7	22	25	-3	19
6	Kpp KVPP Prizreni	13	6	7	22	25	-3	19
7	Kpp Ahmet Hoxha	13	2	11	7	36	-29	15
8	Kpp Hasan Prishtina	13	1	12	6	36	-30	14

Rezultatet e xhirove 12 dhe 13

Java	Ekipi Vendas	Rezultati	Ekipi Mysafir
12	Kpp Bifurkacioni	0 – 3	Kpp Vushtrria
12	Kpp Gani Maloku	3 – 0	Kpp Hasan Prishtina
12	Kpp TTC Ferizaj	3 – 1	Kpp Ahmet Hoxha
12	Kpp Ponte Prizreni	3 – 0	Kpp KVPP Prizreni
13	Kpp Vushtrria	0 – 3	Kpp Gani Maloku
13	Kpp Hasan Prishtina	1 – 3	Kpp Bifurkacioni
13	Kpp Ahmet Hoxha	0 – 3	Kpp Ponte Prizreni
13	Kpp KVPP Prizreni	1 – 3	Kpp TTC Ferizaj